

GJINIA DHE KORRUPSIONI: ÇFARË DIMË NE?

Dokument për Diskutim

PËRMBAJTJA

Përmbajtja.....	4
Sfondi.....	5
Hyrja.....	6
Konceptet.....	7
Pasqyrë e formave të ndryshme të korrupsionit.....	8
Gratë në parlament – forcë kundër korrupsionit apo mit i puritetit? Origjina e hulumtimeve mbi gjininë dhe korrupsionin.....	9
Çfarë roli mund të luajnë gratë në luftën kundër korrupsionit?.....	12
Cilat janë efektet diferenciale të korrupsionit tek burrat dhe gratë?.....	13
Lidhjet mes varfërisë dhe korrupsionit.....	14
• Qasja në shërbime.....	15
• Arsimi.....	16
• Punësimi.....	16
• Konfliktet dhe krizat.....	17
• Migracioni.....	18
• Grupet e pakicave.....	18
• Toka dhe burimet natyrore.....	19
A përjetojnë burrat dhe gratë forma të ndryshme korrupsioni? Roli i shantazhit seksual (sextortion ne anglisht-- sekstorsion).....	21
Konkluzionet dhe rekomandimet.....	23
Praktikat e mira në zhvillim.....	23
Rekomandime për shqyrtim nga strukturat ekzekutive të OSBE-së.....	25
Referencat.....	27

Rishikimi dhe kontributi akademik:
Dr. Ortrun Merkle
studiuese në Universitetin e Matrihtit dhe Universitetin e Kombeve të Bashkuara-MERIT, me qendër në
Matriht, Holandë

Koordinimi dhe mbikëqyrja e përgjithshme:
Sylvi Bratten, Amarsanaa Darisuren, Giulia Sechi
OSBE/Sekretariati, Programi për Çështjet Gjinore, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëma

Rishikimi editorial:
Amarsanaa Darisuren

equality@osce.org
www.osce.org/secretariat/gender

© OSCE 2021

OSBE-ja ka investuar kujdes maksimal në hartimin e këtij botimi. Megjithatë, ajo nuk pranon asnjë përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e informacionit, udhëzimeve dhe këshillave të ofruara, ose për gabime shtypi. Pikëpamjet e shprehura këtu janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën ose qëndrimin zyrtar të OSBE-së dhe shteteve të saj pjesëmarrëse. Për këto arsye, nuk mund të ngrihet asnjë pretendim kundër OSBE-së në lidhje me pasojat e mundshme që mund të lindin nga informacioni ose konkluzionet e përfshira në këtë botim.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Korrupsioni është një abuzim i pushtetit për përfitime private dhe ndikimet e tij janë të gjera për sa i përket ngecjes së rritjes ekonomike, devijimit të fondeve nga infrastruktura thelbësore dhe minimit të besimit të publikut. Korrupsioni është trajtuar prej kohësh si një temë “neutrale nga ana gjinore”, por gjithnjë e më shumë vëmendje i është kushtuar faktit që gratë dhe burrat dukshëm kanë përvoja të ndryshme të korrupsionit.

Literatura e hershme akademike mbi lidhjen midis gjinisë dhe korrupsionit u fokusua në lidhjet e dukshme midis niveleve më të larta të pjesëmarrjes politike të grave dhe niveleve më të ulëta të korrupsionit në vende të veçanta. Studimet ngritën një sërë teorish nëse gratë mbajnë qëndrime të ndryshme ndaj korrupsionit sesa burrat (a janë gratë më paktë prirura ndaj korrupsionit?) ose nëse faktorët institucionalë kufizojnë mundësitë e grave për t'u përfshirë në korrupsion (a nënkuptojnë gjithashtu të njëjtat barrierat që pengojnë pjesëmarrjen e grave në politikë se ato janë të përjashtuara nga rrjetet e korruptuara?).

Zbatimi i perspektivës gjinore ndaj korrupsionit më gjerësisht tregon se gratë dhe burrat kanë nivele të ndryshme të ekspozimit ndaj korrupsionit dhe gjithashtu se vetë korrupsioni ka ndikime gjinore. Rolet dhe përgjegjësitë e ndryshme të burrave dhe grave në shoqëri nënkuptojnë se në disa sfera burrat janë në rrezik për korrupsion (për shembull, si shumica e pronarëve të bizneseve ose punëtorëve informalë). Megjithatë, për shkak se gratë priren të kenë më shumë ndërveprim me shërbimet publike, ato janë të ekspozuara ndaj formave të tjera të korrupsionit (për shembull, ndaj praktikave korruptive që lidhen me ofrimin e kujdesit shëndetësor ose në arsim). Mosbalancimi gjinor i pushtetit dhe i burimeve nënkupton gjithashtu

se ndikimet direkte dhe indirekte të korrupsionit ndjehen ndryshe nga gratë dhe burrat. Gratë përballen me rreziqe më të mëdha për varfërinë dhe kështu mund t'u mohohen shërbimet nëse nuk kanë mundësi të bëjnë pagesa joformale. Gratë migrante, personat e zhvendosur brenda vendit dhe refugjatët janë në rrezik korrupsioni për shkak të pozitave të tyre më të cenueshme. Diskriminimi i shumëfishtë, si ai i bazuar në statusin e gjinisë dhe të pakicave, gjithashtu rrit rrezikun për t'u shënjestruar nga praktikatat korruptive.

Gratë përballen me ekspozim ndaj formave të veçanta të korrupsionit, të tilla si shantazhi seksual në këmbim të një përfitimi (i quajtur “sextorsion” (sextortion)). Kjo formë gjinore e korrupsionit prek kryesisht gratë në sektorin e arsimit, gjatë migrimin dhe në situata konflikti e humanitare.

Një studim i mëtejshëm nevojitet për të dhënë një pamje më të nuancuar të lidhjeve ndërmjet gjinisë dhe korrupsionit dhe ky punim synohet të jetë si pikënisje për diskutimet e brendshme mbi masat kundër korrupsionit që u përgjigjen çështjeve gjinore. Punimi ofron gjithashtu disa shembuj të praktikave premtuese për përfshirjen e perspektivës gjinore në punën kundër korrupsionit. Dokumenti përfundon me disa rekomandime drejtuar OSBE-së për të shqyrtuar mënyrat e përfshirjes së gjinisë në programet, projektet dhe aktivitetet e saj kundër korrupsionit. Së fundi, përfshirja e perspektivave të grave në përpjekjet kundër korrupsionit do të kontribuojë në vendimmarrje dhe programim më të informuar.

SFONDI

OSBE-ja dhe Shtetet e saj pjesëmarrëse kanë pranuar se “korrupsioni përfaqëson një nga pengesat kryesore për prosperitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Shteteve pjesëmarrëse, që minon stabilitetin dhe sigurinë e tyre dhe kërcënon vlerat e përbashkëta të OSBE-së”.¹ Për këtë arsye, Organizata ka miratuar masa të shumta për të adresuar problemin.

Angazhimi më i fundit i OSBE-së për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit përmes dixhitalizimit dhe rritjes së transparencës kujton se “korrupsioni prek në mënyrë disproporcionale gratë dhe të pambrojturit”.² Vendimi i Këshillit Ministror Nr. 6/20 u bën thirrje Shteteve pjesëmarrëse që, ndër të tjera, të promovojnë **“pjesëmarrjen e plotë, të barabartë dhe kuptimplote të grave në zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve përkatëse kundër korrupsionit, me synimin për të arritur barazinë gjinore...”**³

Kjo nuk është hera e parë që OSBE-ja ka nënvizuar rëndësinë e pjesëmarrjes së plotë dhe të barabartë të grave dhe burrave në luftën kundër korrupsionit; kjo është vënë në dukje edhe në Deklaratën Ministrore nr. 2/12.⁴ Megjithatë, angazhimet e OSBE-së në lidhje me anti-korrupsionin në përgjithësi nuk kanë pasur një dimension gjinor - as duke përmendur ndikimet diferenciale të korrupsionit tek gratë dhe burrat dhe as se si një perspektivë gjinore mund të përfshihet në përpjekjet kundër korrupsionit të Shteteve pjesëmarrëse. Angazhime të tjera kundër korrupsionit përfshijnë:

- **Vendimin e Këshillit Ministror Nr. 5/14 për parandalimin e korrupsionit;**

- **Vendimin e Këshillit Ministror Nr. 4/16 për forcimin e qeverisjes së mirë dhe promovimin e konektivitetit; dhe**

- **Vendimin e Këshillit Ministror Nr. 5/18 për zhvillimin e kapitalit njerëzor në fushën dixhitale.**

Programi i Sekretariatit të OSBE-së për Çështjet Gjinore porositi këtë rishikim të brendshëm të kërkimeve akademike në fushën e gjinisë dhe korrupsionit për të shërbyer si bazë për diskutimet e brendshme mbi masat kundër korrupsionit që u përgjigjen çështjeve gjinore.

Pasqyra e ofruar nuk është aspak shteruese, por është një pikë nisjeje për gjenerimin e mëtejshëm të njohurive dhe rekomandimeve për aktivitetet e OSBE-së.

Punimi u përgatit me kontributin akademik të Dr. Ortrun Merkle, studiuese në Universitetin e Mastrihtit dhe Universitetin e Kombeve të Bashkuara-MERIT, me qendër në Mastriht, Holandë.

Programi i OSBE/OSG-së për Çështjet Gjinore dëshiron të shpreh mirënjohjen për anëtarët e grupit të brendshëm të punës të OSBE-së për çështjet gjinore dhe anti-korrupsion për komentet dhe kontributin e tyre thelbësor në hartimin e rekomandimeve të përfshira në këtë dokument.

¹ MC Decision No. 11/04 on Combating Corruption, 7 December 2004.

² MC Decision No. 6/20 on Preventing and Combating Corruption through Digitalization and Increased Transparency, 4 December 2020. MC.DEC 06/2020

³ Ibid.

⁴ Ministerial Declaration No. 2/12 on strengthening good governance and combating corruption, money laundering and the financing of terrorism, 7 December 2012, MC.DOC/2/12.

HYRJE

Duke marrë parasysh zbulimin e skandaleve korruptive në të kaluarën, si ato që u ekspozuan në dokumentet e bëra publike që u quajtën Dokumentat e Panamasë (Panama Papers), një fakt befasues ende merr shumë pak vëmendje në titujt ndërkombëtarë: pabarazia gjinore tek ata që përfitojnë nga korrupsioni në shkallë të gjerë dhe evazioni fiskal.⁵ Shumica dërmuese e evaziuesve fiskal (shmangësve të taksave) të përmendur tek Dokumentat e Panamasë ishin burra të pasur, të fuqishëm dhe shumë pak gra u përmendën.⁶ Rasti i Dokumentave të Panamasë është një ilustrim i qartë se si barrat dhe përfitimet nga korrupsioni ndahen në mënyrë të pabarabartë, jo vetëm midis të pasurve dhe të varfërve, por edhe midis burrave dhe grave. Ky dokument eksploron se si korrupsioni dhe (pa)barazia gjinore janë të ndërlidhura dhe pse është thelbësore të zbatohet një lente gjinore në përpjekjet kundër korrupsionit.

Diskutimet për aspektet gjinore të korrupsionit nuk janë të reja. Gjatë dekadave të fundit, një korrespondencë e qartë është dokumentuar midis vendeve që kanë nivele të larta korrupsioni dhe nivele të ulëta të barazisë gjinore, veçanërisht në pjesëmarrjen politike, dhe anasjelltas.⁷ Ky vëzhgim ka nxitur diskutime rreth rëndësisë së përfshirjes së perspektivës gjinore në politikat dhe kërkimet shkencore kundër korrupsionit. Siç do të tregojë ky dokument, lidhjet e sakta ndërmjet gjinisë dhe korrupsionit janë ende duke u debatuar. Megjithatë, studimet gjithëpërfshirëse kanë ndihmuar në zbërthimin e këtyre marrëdhënieve⁸ dhe tregojnë se fusha e anti-korrupsionit nuk është neutrale nga pikëpamja gjinore siç është supozuar prej kohësh.

Interesi akademik për mënyrën se si gjinia ndërthuret me korrupsionin filloi të tërheqë një interes të konsiderueshëm që nga viti 2001, kur dy punime themelore nga Dollar, Fisman dhe Gatti (2001) dhe Swamy, Knack dhe Lee (2001) analizuan lidhjet midis niveleve më të larta të pjesëmarrjes politike të grave dhe niveleve më të ulëta të korrupsionit. Ndërsa një pjesë e konsiderueshme e literaturës akademike ende fokusohet në angazhimin politik të grave si lidhje e korrupsionit dhe gjinisë, çështje të tjera të rëndësishme kanë tërhequr vëmendjen gjithashtu, si ndikimet diferenciale të korrupsionit tek gratë dhe burrat dhe, së fundi, format e ndryshme të korrupsionit me të cilat përballen burrat dhe gratë.

Ky punim ofron një pasqyrë të kërkimeve aktuale më të fundit mbi korrupsionin dhe gjininë, duke filluar me temën e pjesëmarrjes politike të grave. Punimi trajton çështjen e rëndësishme se si burrat dhe gratë ndikohen ndryshe nga korrupsioni, duke u fokusuar në fushat që janë të rëndësishme për mandatin e OSBE-së. Diskutimi nxjerr në pah çështjen e "shantazhit seksual"⁹, një formë korrupsioni që prek gratë në mënyrë disproporcionale, dhe veçanërisht gratë që janë në pozita të pafavorizuara për shkak të varfërisë, statusit të migrantit, apo aftësive të kufizuara ose për shkak se i përkasin një grupi të një pakice, për shembull. Punimi përfundon duke nënvizuar praktika të përzgjedhura premtuese dhe propozon disa qasje për integrimin e çështjeve gjinore në punën e OSBE-së kundër korrupsionit.

⁵ Mediat që kanë analizuar dokumentat e kanë diskutuar këtë fakt (p.sh. Capraro & Rhodes, 2016), por ende nuk ka literaturë akademike mbi këtë temë.

⁶ Për informacion mbi lojtarët e fuqishëm tek Dokumentat e Panamasë shih ICIJ (n.d.).

⁷ (Alexander & Bågenholm, 2018). Ky punim nuk fokusohet në eksplorimin e lidhjeve ndërmjet pjesëmarrjes politike të grave dhe korrupsionit, por meqenëse interesi akademik në këtë fushë buron nga kërkimet mbi këtë marrëdhënie, është përfshirë një përmbledhje e shkurtër e këtij debati.

⁸ (e.g. Bjarnegård, 2013; Dollar et al., 2001; Goetz, 2007; Rothstein, 2017; Stensöta & Wängnerud, 2018; Sundström & Wängnerud, 2016; Sung, 2003; Swamy et al., 2001)

⁹ Sextortion (seksorsioni) (shantazhi seksual) përkufizohet si "shpërdorim i pushtetit për të marrë një favor seksual" (IAWJ, 2012, p. 9)

KONCEPTET

Korrupsioni është një fenomen shumështrësor dhe kompleks. Në këtë punim, korrupsioni përkufizohet si “shpërdorim i pushtetit të besuar për përfitime private.”¹⁰ E rëndësishme është se ka shumë përkufizime të ndryshme të korrupsionit. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) nuk e përcakton korrupsionin, por përkundrazi përcakton një sërë veprash penale që duhet të mbulohen nga çdo juridiksion dhe të kriminalizohen: “ryshfeti i zyrtarëve publikë vendas dhe të huaj dhe atyre në sektorin privat, shpërdorimi i fondeve, pastrimi i parave, fshehja dhe pengimi i drejtësisë.”¹¹ Korrupsioni shkon përtej çështjes së ryshfetit dhe përfshin nepotizmin, patronazhin, vjedhjen zyrtare, mashtrimin dhe probleme të konfliktit të interesave.¹²

Për të shqyrtuar plotësisht dimensionet gjinore të korrupsionit, kërkohet një përkufizim i gjerë që përfshin edhe konceptet tradicionale, si nepotizmi dhe ryshfeti, edhe dukuritë e diskutuara së fundmi, si sekstorsioni (shantazhi seksual). Në këtë kontekst, është e rëndësishme të kuptohet se “përfitimi privat” nuk duhet të jetë domosdoshmërisht monetar¹³, por mund të përfshijë përfitime për partitë politike ose anëtarë të caktuar të grupeve, si dhe akte seksuale.

¹⁰ Transparency International (n.d.)

¹¹ Hechler et al. (2019, para. 4)

¹² Johnston (2005)

¹³ Bayley (1966)

PASQYRË E FORMAVE TË NDRYSHME TË KORRUPSIONIT

Korrupsioni mund të klasifikohet si korrupsion i madh (politik), i cili përfshin vendimmarrësit më të lartë politikë, dhe korrupsion burokratik, i cili ndodh në nivelin e zbatimit të politikave.¹⁴ Një akt korruptiv zakonisht kërkon të paktën dy palë, të cilat mund të kenë shkallë të ndryshme vullneti për t'u përfshirë. Akti korruptiv mund të jetë një bashkëpunim i vullnetshëm midis një paguesi të një ryshfeti dhe një marrësi të ryshfetit, një nxjerrje me forcë ryshfeti, ose një pagues ryshfeti që parashikon përfitimet e ardhshme. Llojet më të zakonshme të korrupsionit janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.¹⁵

Lloji i korrupsionit	Përkufizimi	Termet e përdorura zakonisht
 RYSHFETI	Pagesë (në para ose në natyrë) që jepet ose merret në një marrëdhënie korruptive	Pagesa ryshfeti (kickbacks), shpërblime, "marrëveshje komerciale", bakshish, para për ryshfet, mitë, pagesa për shlyerje hesapësh, para të shpejta nëndorë ose para ryshfeti për të përshpejtuar një proces (speed- or grease money)
 SHPËRDORIMI I FONDEVE	Vjedhja e burimit/burimeve nga njerëz që janë në pozicione për të menaxhuar burimet	Oferta të dyfishta, vjedhje zyrtare
 MASHTRIMI	Krim ekonomik që përfshin një lloj dinakërie mashtruese, zhvatje, ose mashtrim përmes genjeshtrës	Përfshirje në rrjete të paligjshme tregtare, falsifikime, shantazhe, falsifikime dokumentash, kontrabandë
 ZHVATJA	Para dhe burime të tjera të nxjerra me shtrëngim ose detyrim, dhunë ose kërcëni për përdorimin e forcës	Shantazh, mbrojtje ose para sigurije, tatimet informale, sekstorsion (shantazh seksual)
 FAVORITIZMI	Mekanizmi i abuzimit me pushtetin që nënkupton 'privatizimin' dhe një shpërndarje shumë të njëanshme të burimeve shtetërore	Kronizëm, nepotizëm, klientelizëm, paragjykim, patronazh

Ky punim përdor termin "gjini" për të përshkruar rolet e përcaktuara nga ana shoqërore për gratë dhe burrat, dhe një identitet të fituar që mësohet, ndryshon me kalimin e kohës dhe ndryshon gjerësisht brenda dhe midis kulturave.

Koncepti i gjinisë si një përshkrim i dallimeve në mundësitë, marrëdhëniet dhe pushtetin e ndikimit që i atribuohet burrave dhe grave është veçanërisht i rëndësishëm në këtë kontekst, pasi përcakton se si burrat dhe gratë preken nga korrupsioni (diskutuar

në pjesën 5) si dhe format e ndryshme të korrupsionit që ata hasin (diskutuar në pjesën 6). Mosbalancimi gjinor i pushtetit luan një rol të madh në korrupsion. Nga njëra anë, në krahasim me burrat, më pak gra kanë mjetet dhe burimet për t'u përfshirë në rrjetet e korruptuara. Nga ana tjetër, rolet dhe detyrat që u janë caktuar grave në shoqëri tregojnë se ato përballen përballen me më shumë ekspozim ndaj disa formave të korrupsionit, drejtpërdrejt dhe tërthorazi.¹⁷

¹⁴ Andvig et al. (2000)

¹⁵ Davis (2004)

¹⁶ Adapted from Andvig et al. (2001, p. 8)

¹⁷ Goetz (2007)

GRATË NË PARLAMENT – FORCË KUNDËR KORRUPSIONIT APO MIT I PURITETIT? ORIGJINA E HULUMTIMEVE MBI GJININË DHE KORRUPSIONIN

Studimet e hershme¹⁸ mbi korrupsionin dhe gjininë u përqendruan në marrëdhëniet midis grave në politikë dhe niveleve të korrupsionit dhe zbuluan se një numër më i madh i grave në parlamentin kombëtar dukej të kishte lidhje me nivele më të ulëta të korrupsionit në një vend të caktuar. Këto gjetje u mbështetën nga studime të mëvonshme që zbuluan se marrëdhënia ishte e vërtetë si në nivele¹⁹ kombëtare dhe rajonale²⁰, ashtu edhe në pozitat në qeveri²¹ dhe në këshillat lokale.²² Një studim i kohëve të fundit²³ që përqendrohej mbi Evropën zbuloi se një rritje e përfaqësimit politik lokal të femrave lidhet me reduktimin e korrupsionit të vogël dhe të madh. Një studim tjetër arriti në përfundimin se e kundërta është e vërtetë, domethënë se nivelet e larta të korrupsionit politik dhe dhunës politike çojnë në një numër më të ulët të grave të zgjedhura në parlamente.²⁴ Këto gjetje ngrejnë pyetje në lidhje me ndërveprimin midis këtyre dy faktorëve, që do të thotë se a mos pjesëmarrja e grave në politikë në fakt e zvogëlon korrupsionin (dhe nëse po, si?) apo mos ekzistenca e korrupsionit e pengon pjesëmarrjen politike të grave?

Ndërsa shkaqet e kësaj marrëdhënieje janë ende duke u debatuar, janë ngritur disa shpjegime të mundshme për lidhjen reciproke midis përfaqësimit politik në rritje të grave dhe niveleve më të ulëta të korrupsionit. Teoritë përfshijnë sa vijon: gratë janë në mënyrë të qenësishme më të ndershme se burrat; gratë janë më pak të prirura ndaj rrezikut

sesa burrat;²⁵ ose gratë politike ndëshkohen më ashpër nga votuesit për korrupsion dhe kjo ka një efekt parandalues.²⁶ Është gjithashtu e mundur që gratë thjesht mund të përjashtohen nga pozicione që lejojnë hapësirë për korrupsion.²⁷ Nga ana tjetër, disa studiues kanë argumentuar se nivelet më të larta të korrupsionit çojnë në nivele më të ulëta të pjesëmarrjes së grave, sepse klima e korrupsionit i privilegjon burrat. Rrjetet e korruptuara të meshkujve do të përjashtonin gratë me qëllim që të mbanin fitimet për vete.²⁸ Hulumtimi më i fundit sugjeron se shkakësia mund të jetë në të dyja drejtimet, ku nivelet më të ulëta të korrupsionit çojnë në shkallë më të larta të pjesëmarrjes së femrave dhe anasjelltas.²⁹

Diskutimet kryesore përqendrohen rreth dy argumenteve, nëse gratë dhe burrat mbajnë qëndrime të ndryshme ndaj korrupsionit ose nëse faktorët institucionalë kufizojnë si pjesëmarrjen politike të grave edhe mundësitë e tyre për t'u përfshirë në korrupsion.

¹⁸ Dollar et al. (2001) and Swamy et al. (2001)

¹⁹ e.g. Bjarnegård (2013), Grimes & Wängnerud, (2010, 2012), Jha & Sarangi (2018), Stockemer (2011), Wängnerud, (2015), as an exception Vijayalakshmi (2008)

²⁰ Subregional level (editor's note)

²¹ (Stockemer & Sundström, 2019)

²² (Sundström & Wängnerud, 2016)

²³ Bauhr, Charron & Wängnerud (2018)

²⁴ Norris (2019)

²⁵ (e.g. Dollar et al., 2001)

²⁶ (e.g. Alatas, Cameron, Chaudhuri, Erkal, & Gangadharan, 2009; Esarey & Chirillo, 2013)

²⁷ (Branisa & Ziegler, 2011; Goetz, 2007; Schwindt-Bayer, 2010; Tripp, 2001)


²⁸ (Bjarnegård, 2013; Stockemer, 2011; Sundström & Wängnerud, 2016)

²⁹ Esarey and Schwindt-Bayer (2019)

Disa kanë argumentuar se gratë mund të kenë më pak gjasa të sakrifikojnë përfitimet personale për të mirën e përbashkët dhe për këtë arsye janë më pak të prirura për t'u përfshirë në sjellje korruptive.³⁰ Në mënyrë të ngjashme, është propozuar që gratë kanë nivele më të larta të vetëkontrollit,³¹ ose ato janë më pak të prirura ndaj rrezikut³² dhe për këtë arsye më pak të gatshme për t'u përfshirë në ndërveprime me zyrtarë kriminalë apo të korruptuar.³³ Për më tepër, gratë mund të ndiejnë presion më të madh për t'iu përshtatur normave shoqërore në lidhje me korrupsionin, pasi ato kanë më shumë gjasa të ndëshkohen për sjellje korruptive.³⁴ Megjithatë, argumenti që evoluoi nga këto gjetje se gratë janë "gjinia më e bukur" ose një "forcë e re më e pastër kundër korrupsionit"³⁵ është kritikuar ashpër që atëherë për shkak se përforcon stereotipet gjinore.³⁶

Faktorët institucionalë duket se luajnë një rol të rëndësishëm në shpjegimin e marrëdhënies ndërmjet korrupsionit dhe pjesëmarrjes politike të grave. Institucionet e forta demokratike kanë qenë të lidhura me shkallë më të ulta të korrupsionit dhe shkallë më të larta të pjesëmarrjes së grave.³⁷ Studime të tjera argumentojnë se nëse një individ përfshihet në korrupsion ose jo është një çështje mundësish dhe qasje në rrjete dhe jo një çështje e dallimeve gjinore.³⁸ Argumenti i fundit është veçanërisht i rëndësishëm, pasi gratë shpesh përjashtohen nga pozitat e pushtetit dhe rrjetet që lejojnë praktika korruptive.³⁹

Grafiku: Përqindja e grave në parlament në rajonin e OSBE-së



³⁰ Dollar et al. (2001)

³¹ Swamy et al (2001)

³² Byrnes, Miller, & Schafer (1999), Eckel & Füllbrunn (2015), Harris, Jenkins, & Glaser (2006)

³³ Frank, Lambsdorff, & Boehm (2011)

³⁴ Esarey & Chirillo (2013)

³⁵ Goetz (2007)


³⁶ UNDP (2012), Goetz (2007), Hazarika (2016)

³⁷ Sung (2003), Esarey and Chirillo (2013), Wängnerud (2014)

³⁸ Alolo (2007), Alatas et al (2009)

³⁹ e.g. Alhassan-Alolo (2007), Bjarnegård (2013), Goetz (2007), Grimes & Wängnerud (2012), Stockemer (2011), Barnes (2016), Heath, Schwindt-Bayer, & Taylor-Robinson (2005), Schwindt-Bayer (2010), Arriola & Johnson (2014), Beck (2003) Bjarnegård (2013)

Tabela X: Përqindja e Grave në Pozita MinistrORE në Rajonin e OSBE-së



Burimi: Treguesit Gjitorë të Bankës Botërore www.worldbank.org/en/data/datatopics/gender Retrieved September 2022

Vëmendje e konsiderueshme i është kushtuar çështjes nëse dhe si korrupsioni pengon pjesëmarrjen e grave në politikë. Hulumtimet tregojnë se korrupsioni mund të jetë një pengesë shtesë për gratë që të bëjnë fushatë, të kandidojnë për poste publike dhe të zgjidhen, kur për shembull, fonde të paligjshme përdoren në zgjedhje.⁴⁰ Korrupsioni, veçanërisht brenda rrjeteve të dominuara nga meshkujt dhe brenda palëve, mund të pengojë potencialin e grave për t'u përzgjedhur si kandidate.⁴¹

⁴⁰ Norris (2019)

⁴¹ E.g. Bjarnegård (2013), Franceschet & Piscopo (2014), Norris & Lovenduski (1995), Stockemer & Sundström (2019), Alhassan-Alolo, (2007), Goetz (2007), Stockemer, (2011), Sundström & Wängnerud (2016), Grimes and Wängnerud (2012), Bjarnegård and Kenny (2016)

ÇFARË ROLI MUND TË LUAJNË GRATË KUNDËR KORRUPSIONIT?

Gratë dhe burrat sjellin çështje të ndryshme në axhendën e politikave dhe ky diversitet është një parakusht për një qasje holistikë ndaj antikorrupsionit. Praktika ka treguar se gratë politike dhe aktiviste priren të ngrenë çështje në lidhje me të drejtat e grave,⁴² mbrojtjen e fëmijëve⁴³ dhe mirëqenien e grupeve të pafavorizuara. Kjo tendencë është veçanërisht e rëndësishme kur zhvillohen iniciativa kundër korrupsionit, veçanërisht ato që fokusohen në popullatat shpesh të anashkaluara dhe të marginalizuara. Një vëmendje dhe mbikëqyrje më e madhe çon në përmirësime në ofrimin e shërbimeve dhe gjithashtu në nivele më të ulëta të korrupsionit në shërbimet publike.⁴⁴ Barazia gjinore në politikë jo vetëm që sjell një fokus në fusha të ndryshme të politikave, por prania e më shumë grave mund të ndikojë apo edhe të shkatërrojë rrjetet e korruptuara të dominuara nga meshkujt dhe si pasojë të luftojë korrupsionin e madh.⁴⁵

Megjithatë, prania e mirëfilltë e grave nuk ka gjithmonë efektin e synuar. Nëse grave nuk u jepet autoriteti vendimmarrës ose nëse ato janë pjesë e të njëjtave rrjete korruptive, kjo mund të kamuflojë çështjet e korrupsionit në një vend.⁴⁶ Si i tillë, konteksti institucional dhe politik gjithashtu luan një rol në përcaktimin nëse gratë do të jenë një forcë

kundër korrupsionit. Gratë kanë më shumë gjasa të kundërshtojnë korrupsionin në mjediset demokratike sesa në ato autoritare, gjë që mbështet argumentin se demokracia është një faktor ndërmjetësues në marrëdhëniet midis pjesëmarrjes politike të grave dhe korrupsionit.⁴⁷

Me rëndësi është se hulumtimi ka treguar gjithashtu se gratë priren të fokusohen në “mungesën e mbrojtjes, frikën nga raprezaljet dhe nivelin e konfidencialitetit” kur vendosin nëse do të raportojnë korrupsionin.⁴⁸ Kjo u konfirmua edhe në Shqipëri, ku një nga gjetjet kryesore të një workshop-i mbi korrupsionin dhe gratë ishte krijimi i mekanizmave raportues të sigurt dhe gjithëpërfshirës gjinor.⁴⁹

Kur merret parasysh roli që gratë mund të luajnë në përpjekjet kundër korrupsionit, është thelbësore të shikohet përtej rritjes së numrit të grave të përfshira dhe të shqyrtohen mënyrat për të mbështetur rrjetet dhe organizatat e grave që do të kenë një ndikim më të madh në përpjekjet kundër korrupsionit.

⁴² e.g. Iyer, Mani, Mishra, & Topalova (2012), Rehavi (2007)

⁴³ e.g. Bhalotra & Clots-Figueras (2014), Brollo & Troiano (2016)

⁴⁴ Alexander & Bågenholm (2018, p. 173), Jha & Sarangi (2018)

⁴⁵ Bauhr et al (2018)

⁴⁶ Nistotskaya & Stensöta (2018)

⁴⁷ Esarey & Chirillo (2013)

⁴⁸ UNODC (2021, p.82)

⁴⁹ ibid

CILAT JANË EFEKTET DIFERENCIALE TË KORRUPSIONIT TEK BURRAT DHE GRATË?

Zbatimi i perspektivës gjinore ndaj anti-korrupsionit kërkon shqyrtimin e mënyrës se si korrupsioni prek gratë dhe burrat në mënyrë të ndryshme, drejtpërdrejt dhe tërthorazi. Marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit midis grave dhe burrave dhe rolet gjinore mund të çojnë në nivele të ndryshme të ekspozimit ndaj korrupsionit. Një studim i fundit mbi diskriminimin dhe korrupsionin diskuton si më poshtë:

Diskriminimi sistematik i grave prodhon dinamika sociale që gjenerojnë çekuilibër të pushtetit dhe lehtësojnë korrupsionin, duke përfshirë forma gjinore të korrupsionit, duke e bërë gjithashtu më të vështirë për gratë viktimë të korrupsionit të kërkojnë drejtësi për abuzimet korruptive të pushtetit.⁵⁰

Për shembull, në sektorin e biznesit, burrat përbëjnë shumicën e pronarëve të ndërmarrjeve dhe zakonisht përfaqësohen në biznese më të mëdha se gratë (të cilat kanë më shumë gjasa të operojnë ndërmarrje mikro ose të vogla), që do të thotë se në

terma absolutë burrat kanë më shumë gjasa të hasin korrupsion në këtë sektor. Megjithatë, gratë mund të jenë ende “proporcionalisht më të cenueshme” ndaj korrupsionit në këtë sektor.⁵¹

Korrupsioni ndikon negativisht në rritjen ekonomike, rrit pabarazinë në të ardhura dhe devijon fondet nga infrastruktura dhe shërbimet thelbësore që përfitojnë të varfërit. Kur fondet e destinuar për shërbime publike devijohen në programe ose projekte që japin më shumë mundësi për të fshehur dhe mbledhur ryshfetet, shërbimet thelbësore dhe sistemet e sigurimeve shoqërore, veçanërisht të përdorura nga gratë, bëhen të nënfinancuara (nuk financohen mjaftueshmërisht).

Për të kuptuar në të vërtetë natyrën gjinore të korrupsionit, duhet të merren parasysh si efektet e tij direkte ashtu edhe ato indirekte. Një akt korruptiv nuk prek vetëm palët e përfshira drejtpërdrejt, por edhe “palët e treta, duke përfshirë popullatën e përgjithshme, taksapaguesit, profesionet specifike ose komunitetet”.⁵²

⁵⁰ Transparency International and Equal Rights Trust (2021, p. 22)

⁵¹ Boehm & Sierra (2015, p. 2)

⁵² Boehm & Sierra (2015, p. 2)

LIDHJET MES VARFËRISË DHE KORRUPSIONIT

Është vërtetuar mirë se korrupsioni prek në mënyrë disproporcionale të varfërit, pasi merr një pjesë më të madhe të të ardhurave të tyre.⁵³ Ndërsa burrat dhe gratë përjetojnë varfëri, hulumtimi tregon se nënat beqare dhe gratë më të vjetra në moshë që jetojnë vetëm përballen me një rrezik më të lartë të varfërisë sesa burrat në familje të ngjashme.⁵⁴ Ka një dimension gjinor të varfërisë. Globalisht, “përqindje më të ulëta të grave në krahasim me burrat marrin të ardhurat e tyre në para në dorë (kesh) nga puna si rezultat i ndarjes së pabarabartë të punës së paguar dhe të papaguar” dhe gratë, veçanërisht kur kanë fëmijë në ngarkim dhe nuk kanë partnerë kanë më shumë gjasa të jenë më të varfëra se burrat.⁵⁵ Korrupsioni redukton të ardhurat e shtetit dhe për këtë arsye ul sasinë e parave të disponueshme për shërbimet publike dhe ul efikasitetin e ofrimit të shërbimeve, i cili supozohet, mesatarisht, të ndikojë më shumë tek gratë sesa tek burrat. Madje edhe kur burrat dhe gratë i përdorin shërbimet me të njëjtin ritëm, gratë shpesh pritet të jenë më të cenueshme ndaj korrupsionit pasi ato kanë më pak ndërmjetësi dhe më pak mbështetje se burrat.⁵⁶

Ndërkohë që korrupsioni është veçanërisht i dëmshëm për gratë që tashmë janë në rrezik më të madh për varfëri, korrupsioni në fushën e ofrimit të shërbimeve mund të rezultojë gjithashtu që grave t’u mohohet qasja në shërbime.⁵⁷ Për shembull, nëse marrësi i ryshfetit supozon se gratë nuk kanë burime për të paguar në fakt një ryshfet, ato mund

të mos kërkojnë prej tyre ryshfet dhe kjo, nga ana tjetër, rezulton në probleme që lidhen me qasjen e grave ndaj shërbimeve. Është e rëndësishme të theksohet se kjo gjithashtu lidhet drejtpërdrejt me gratë që luajnë një rol të rëndësishëm në përpjekjet kundër korrupsionit. Siç ka treguar hulumtimi në mënyrë të përsëritur, gratë në poste politike priren të fokusohen në politika që përmirësojnë kushtet e jetesës së grave dhe vajzave, ato gjithashtu përmirësojnë monitorimin dhe ofrimin e shërbimeve publike, gjë që ul korrupsionin në ata sektorë.⁵⁸ Një studim që shqyrton nivelin e këshillit vendor në Evropë zbuloi, për shembull, se një rritje e ekuilibrit gjinor në këshillat vendore lidhet me nivele më të ulëta të korrupsionit në prokurimet publike.⁵⁹

Programet e sigurimeve shoqërore që synojnë lehtësimin e varfërisë mund gjithashtu të jenë në shënjestër për korrupsion. Sigurimi shoqëror në formën e rishpërndarjes së burimeve “përmes moshave, klasave, profesioneve dhe gjinive” bëhet kryesisht nëpërmjet programeve sociale, duke përfshirë përfitimet e papunësisë dhe pensionet, që zakonisht kanë vlerë shumë të lartë monetare. Prandaj, programe të tilla janë një ‘objektiv interesant’ për korrupsionin, duke i lënë pa mbrojtje ata më të cenuarit.

⁵³ Hunt & Laszlo (2012), Justesen & Bjørnskov (2014)

⁵⁴ UNSD (2015)

⁵⁵ United Nations (2015, p. xiv)

⁵⁶ UNODC (2020, p. 43)

⁵⁷ Chêne et al. (2010)

⁵⁸ Alexander & Bagenholm (2018)

⁵⁹ Bauhr et al. (2019)

• QASJA NDAJ SHËRBIMEVE

Një pjesë më e madhe e burrave janë të punësuar jashtë familjes, ndërsa gratë janë të mbipërfaqësuar në mesin e atyre që nuk janë në fuqinë punëtore, sepse ato marrin përgjegjësinë kryesore për punën e papaguar të shtëpisë dhe përkujdesjes. Këto përgjegjësi të kujdesit nënkuptojnë se gratë kanë më shumë gjasa se burrat të ndërveprojnë me ofrues të caktuar shërbimesh (p.sh. kujdesi shëndetësor, arsimit dhe shërbimet sociale) dhe për këtë arsye janë më të ekspozuara ndaj korrupsionit në këta sektorë.⁶⁰ Kjo situatë është e evidente për faktin se gratë përballen me sfida specifike gjinore në qasjen ndaj shërbimeve të kujdesit shëndetësor riprodhues. Për shembull, një rast studimor nga Ukraina zbuloi korrupsion të përhapur pasi rreth 50 përqind e pacientëve të shtruar kanë raportuar se kanë bërë pagesa informale për shërbimet e kujdesit shëndetësor në rastet e shtatzënisë ose lindjes.⁶¹ Ndërsa gratë priren të jenë më të ekspozuara ndaj korrupsionit në këta sektorë, mund të supozohet se pagesat e ryshfetit që duhet të jepen këtu ndikojnë në gjendjen financiare të të gjithë familjes, veçanërisht kur gratë nuk janë të angazhuara në punë me pagesë.

Pandemia e Covid-19-të ka ndikuar tek gratë në shumë mënyra. Ato jo vetëm që përbëjnë shumicën e punonjësve të kujdesit shëndetësor, por gjithashtu shpesh përbëjnë një pjesë të madhe të punëtorëve thelbësorë me kualifikim të ulët që janë ende duke punuar gjatë kësaj krize.⁶² Gjatë pandemisë së Covid-19-të, gratë gjithashtu kanë marrë në mënyrë disproporcionale përgjegjësi shtesë të kujdesit, gjë që mund të rrisë më tej cenueshmërinë e tyre ndaj korrupsionit në ata sektorë. Hulumtimet e mëparshme kanë treguar gjithashtu se gjatë krizës humanitare gratë përballen me rreziqe më të larta të shfrytëzimit seksual dhe kjo mund të përfshijë një rrezik në rritje për t'u përballur me shantazhin seksual (seksorsion-in).⁶³ Përveç kësaj, gratë kishin më shumë gjasa të humbin punën e tyre, për shkak

të pabarazive ekzistuese gjinore. Gratë priren të jenë të mbipërfaqësuar në sektorë që u goditën më shumë nga pandemia, si mikpritja dhe shërbimi ushqimor, shitja me pakicë dhe shërbime të tjera.⁶⁴

Edhe korrupsioni policor⁶⁵ ka një dimension gjinor. Në disa raste, burrat mund të hasin më shpesh një korrupsion të tillë, sepse ata kalojnë më shumë kohë jashtë shtëpisë dhe potencialisht kanë më shumë kontakte me policinë (për shembull, ryshfetet dhe pagesat joformale në lidhje me ndalimin e trafikut). Nga ana tjetër, korrupsioni në sistemet e zbatimit të ligjit dhe atë gjyqësor mund të ketë një efekt të thellë tek gratë që janë viktime të dhunës me bazë gjinore. Gratë kanë më pak gjasa të kërkojnë ndihmë nga policia ose gjykata nëse u mungojnë burimet financiare dhe/ose kanë frikë nga korrupsioni. Gratë dhe vajzat janë gjithashtu shpesh më të rrezikuara për t'u përballur me korrupsionin kur hyjnë në sektorin e drejtësisë; madje edhe kur ato teknikisht kanë të njëjtat të drejta si burrat, shpesh mund të mos jetë e mundur t'i aksesojnë ato në të njëjtën mënyrë.⁶⁶ Ky është veçanërisht rasti kur raportohet për korrupsion. Siç u diskutua më parë, për shumë arsye, të tilla si normat gjinore, gratë shpesh kanë më pak burime në dispozicion se burrat. Në një sektor të korruptuar të drejtësisë, kjo do të thotë se pala me më shumë burime mund të nxisë për rezultate më të mira dhe për këtë arsye t'i pengojë gratë të kërkojnë drejtësi. Gratë gjithashtu mund t'i nënshtrohen llojeve specifike të korrupsionit, si p.sh. shantazhi seksual (seksorsioni) nga organet e zbatimit të ligjit (për një diskutim të detajuar mbi këtë formë korrupsioni shih pjesën 6).

Lidhjet ndërmjet korrupsionit, zbatimit të ligjit dhe sistemit të drejtësisë në kontekstin e Dhunës me Bazë Gjinore kanë nevojë për eksplorim të mëtejshëm.

⁶⁰ For examples from Ukraine see Gerasymenko, G. (2018)

⁶¹ Stepurko et al. (2015)

⁶² Transparency International (2020)

⁶³ Gichohi & Kirya (2021)

⁶⁴ Madgavkar, 2020

⁶⁵ Korrupsioni policor përkufizohet si "një officer/e që me vetëdije bën ose nuk bën diçka që është kundër detyrës së tij/saj për ndonjë formë përfitimi financiar ose material ose premtim për një përfitim të tillë" (Punch, 2009, p. 18).

⁶⁶ Transparency International (2019)

• ARSIMI

Korrupsioni në sektorin e arsimit nuk është një fenomen i rrallë dhe luan një rol në faza të ndryshme të procesit arsimor, si gjatë provimeve pranuese dhe procesit të pranimit, kur caktohen klasat, kur jepen bursa të plota ose të pjesshme, si dhe në përgatitjen e punës kërkimore (të fallsifikuar).⁶⁷ Korrupsioni gjithashtu ul shpenzimet e qeverisë në sektorin e arsimit.⁶⁸ Gratë dhe vajzat, veçanërisht ato që janë të varfra, mbështeten më shumë në ofrimin publik të arsimit pasi ato janë veçanërisht të ndikuara negativisht nga kjo. Duke përdorur rastin e Ugandës, një studim tregon se zbatimi i masave të transparencës uli sasinë e fondeve të devijuara në xhepat privatë dhe rriti regjistrimin dhe mësimin e studentëve në Uganda.⁶⁹ Korrupsioni në sektorin e arsimit pengon suksesin arsimor të individëve, kur korrupsioni ul cilësinë e arsimit publik, gratë e varfra dhe të marginalizuara nuk kanë mundësi të ndjekin shkolla private ose shërbime tutoriale ose potencialisht të devijojnë para nga fusha të

• PUNËSIMI

Korrupsioni në punësim është i lidhur ngushtë me punën në sektorin informal. Puna informale i referohet aktiviteteve të punëtorëve dhe njësive ekonomike që – në ligj ose në praktikë – nuk mbulohen ose mbulohen në mënyrë të pamjaftueshme nga marrëveshjet formale.⁷⁴ Sektori informal ofron përfitime të përziera për punëtorët. Ndërsa disa mund të shohin mundësi më të mira se sa në sektorin formal, për të tjerët është një mjet i fundit për të shmangur papunësinë. Punëtorët informale përballen me kushte të pasigurta pune me “rreziqe të ndryshme – shëndeti, siguria në punë, humbja e të ardhurave – pa mbrojtje adekuate”⁷⁵ (si qasja në sigurime shëndetësore, sigurime shoqërore dhe pensione).

Ndërsa gratë në shumë vende janë të mbipërfaqësuar në sektorin informal,⁷⁶ ku të dhënat janë të disponueshme për nën-rajone të veçanta të OSBE-së, burrat përbëjnë shumicën e punëtorëve informale. Megjithatë, burrat dhe gratë kryejnë dukshëm lloje të ndryshme të punës informale (për shembull punë në ndërtim për burrat dhe punë

tjera të jetës, siç janë kujdesi shëndetësor ose pagesat e qirasë.⁷⁰ Ai gjithashtu ul cilësinë e arsimit në përgjithësi, gjë që zvogëlon rritjen dhe normat ekonomike të kthimit në arsimin e lartë.⁷¹ Korrupsioni në sektorin e arsimit është veçanërisht problematik pasi “korrupsioni sistematik arsimor (...) përfshin të miturit ose të rinjtë dhe dëmton aftësinë e arsimit për t’i shërbyer një të mire publike, veçanërisht zgjedhjen e liderëve të ardhshëm mbi baza të drejta dhe të paanshme [...]”.⁷²

Shantazhi seksual (sekstorsion-i), ose kërkesa për favore seksuale, është një formë veçanërisht problematike e korrupsionit që ekziston në sektorin e arsimit. Sekstorsion-i është në vetvete një formë gjinore e korrupsionit që ka ndikime veçanërisht negative në ndjekjen e shkollës dhe arritjet akademike të vajzave dhe grave.⁷³ Tema e sekstorsion-it diskutohet në pjesën 6 të këtij punimi.

shtëpiake për gratë), gjë që i lë ata të cenueshëm ndaj formave specifike të korrupsionit. Për më tepër, në vendet ku vajzat nuk kanë të njëjtën akses në arsim dhe trajnim profesional, gratë kanë më shumë gjasa t’i bashkohen sektorit informal.⁷⁷ Punëtorët informale në përgjithësi janë më të cenueshëm ndaj korrupsionit dhe shpesh shihen si objektiva të përsosur për agjencitë e zbatimit të ligjit dhe burokratët e nivelit të rrugës për të kërkuar ryshfet.⁷⁸ Ndërsa burrat dhe gratë në sektorin informal janë të cenueshëm ndaj korrupsionit, mbetet për t’u studiuar se si klasifikohet kjo cenueshmëri në gjini. Megjithatë, gratë shpesh mund të kenë më pak mjete për të luftuar përpjekjet për korrupsion nga zyrtarët⁷⁹ dhe kanë më shumë gjasa të përballen me shantazhin seksual (sekstorsion-in) si një formë korrupsioni. Kjo e fundit ka dy arsye. Së pari, dihet mirë se të qenit grua në vetvete mund ta bëjë dikë një objektiv për abuzime seksuale; përveç kësaj, në sektorin informal, gratë shpesh nuk kanë të njëjtin kontroll mbi asetet financiare si burrat.⁸⁰

⁶⁷ Za detaljan pregled oblika korupcije i počnilaca u oblasti obrazovanja videti Heyneman (2011) i Heyneman et al. (2008)

⁶⁸ Mauro (1995)

⁶⁹ Reinikka & Svensson (2005)

⁷⁰ Bullock & Jenkins (2021, p. 9)

⁷¹ Heyneman (2011, p. 19)

⁷² Heyneman (2011, str. 13)

⁷³ Leach et al. (2014)

⁷⁴ Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) e koncepton gjerësisht ekonominë informale për të përfshirë “të gjitha aktivitetet ekonomike

nga punëtorët dhe njësitë ekonomike që, në ligj apo në praktikë, nuk mbulohen ose mbulohen në mënyrë të pamjaftueshme nga marrëveshjet formale” (OECD/ILO, 2019, f. 16)

⁷⁵ Jütting & de Laiglesia (2009, p. 18)

⁷⁶ Chen (2001)

⁷⁷ Otake (2017)

⁷⁸ Bullock & Jenkins (2020)

⁷⁹ Boehm, F. & Sierra, E. (2015)

⁸⁰ Transparency International and Equal Rights Trust (2021)

Korrupsioni mund të çojë në rritjen e sektorit informal pasi kostot dhe koha e nevojshme për të ngritur një biznes në sektorin formal rriten nëpërmjet ryshfeteve për burokratët dhe rregullatorët. Korrupsioni gjithashtu mund të ndikojë negativisht në mundësitë e punësimit në sektorin formal. Nepotizmi dhe rrjetet e patronazhit mund të përjashtojnë individët e kualifikuar nga punësimi si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Nepotizmi në sektorin privat

• KONFLIKTI DHE KRIZAT

Korrupsioni është i lidhur me vendet e prekura nga konflikti, Shtetet e brishta dhe shoqëritë pas konfliktit. Mundësia e konfliktit të dhunshëm rritet kur korrupsioni është i shfrenuar dhe sistemet e drejtësisë nuk funksionojnë siç duhet. Korrupsioni ndikon negativisht në legjitimitetin e shtetit.⁸² Kjo mund të inkurajojë qytetarët të rebelohen,⁸³ gjë që mund të kthehet shpejt në konflikt të dhunshëm. Në të njëjtën kohë, korrupsioni mund të ulë kohezionin social⁸⁴ dhe të rrisë paqëndrueshmërinë. Është dokumentuar mirë se efektet e konfliktit janë shumë gjinore. Ndërsa burrat kanë një rrezik më të lartë të vdekshmërisë dhe lëndimeve të lidhura me betejën, gratë dhe fëmijët janë në rrezik më të lartë për t'u zhvendosur.⁸⁵ Konflikti gjithashtu sjell ndryshime në rolet gjinore brenda shoqërisë dhe familjes. Grave u kërkohet të marrin një rol më aktiv në tregun e punës. Megjithatë, gjatë konfliktit ato mund të kenë akses në vende pune vetëm në sektorë të pasigurt, me aftësi të ulëta dhe me pagesë të ulët.⁸⁶ Kriza gjithashtu shton ndjeshëm shtrirjen dhe vëllimin e punës së kujdesit që bëjnë gratë.⁸⁷ E rëndësishme është që gratë përballen me një rrezik të shtuar⁸⁸ të dhunës me bazë gjinore gjatë dhe pas konfliktit, veçanërisht dhunës seksuale, e cila kapasojta të konsiderueshme fizike dhe mendore.⁸⁹

nuk ka marrë një vëmendje të gjerë në debatin akademik, megjithatë dëshmitë anekdotike tregojnë se “nepotizmi është një pjesë e etabluar e kulturës së biznesit”.⁸¹ Një hulumtim i dedikuar është i nevojshëm për lidhjet ndërmjet korrupsionit dhe punësimit sa informal aq dhe të pasigurt në përgjithësi. Më e rëndësishmja është që duhet të integrohet një perspektivë gjinore.

Korrupsioni në sektorin humanitar ndikon ndryshe tek burrat dhe gratë. Urgjenca e ndihmës humanitare dhe cenueshmëria e lartë e marrësve mund ta bëjnë më të lehtë korrupsionin. Në kontekstet e krizës, gratë mund të jenë veçanërisht të cenueshme për shkak të pabarazisë para-ekzistuese dhe sidomos, për shkak të përgjegjësive të tyre të shtuara për kujdesin.⁹⁰ Gratë kanë gjithashtu një nevojë të shtuar për shërbime shëndetësore gjatë konfliktit dhe krizës humanitare, “për shkak të cenueshmërisë sociale dhe biologjike”.⁹¹ Emigrantet femra dhe refugjatet gjithashtu përballen me një rrezik në rritje për t'u ekspozuar ndaj korrupsionit siç do të diskutohet në seksionin vijues.

⁸¹ Mulgan (2000)

⁸² Rose-Ackerman (1996)

⁸³ Clausen, Kraay, & Nyiri (2011)

⁸⁴ Një shembull i efektit negativ të korrupsionit në ndërtimin e kohezionit social është korrupsioni i shfrenuar në sektorin e arsimit. Shihni këtë studim mbi Gjeorgjinë, Kazakistanin dhe Kirgistanin: Heyneman (2007).

⁸⁵ Buvinic et al. (2013)

⁸⁶ Justino et al. (2012)

⁸⁷ Shënimi i redaktorit

⁸⁸ Burrat dhe djemtë mund të jenë gjithashtu viktimat e dhunës me bazë gjinore, veçanërisht gjatë konflikteve, dhe kjo formë e dhunës në përgjithësi është e nën-raportuar. Megjithatë, të dhënat ekzistuese sugjerojnë se gratë dhe vajzat përballen me rreziqe të larta për dhunë me bazë gjinore gjatë konfliktit dhe krizave të tjera, shut si në kohë paqeje.

⁸⁹ Sivakumaran (2010)

⁹⁰ Shënimi i redaktorit

⁹¹ Chene (2009, str. 2)

• MIGRACIONI

Korrupsioni mund të luajë një rol në migracionin. Si gratë ashtu edhe burrat që janë të përfshirë në migracion të parregullt mund të përjetojnë korrupsion në pika të ndryshme gjatë rrugëtimit. Megjithatë, mënyra se si përjetohe korrupsioni ndryshon rrënjësisht sipas gjinisë, jo vetëm nga forma e korrupsionit, por edhe nga pasojat e mospagesës së rryshfetit.

Gjatë procesit të migracionit të parregullt, gratë që hasin korrupsion shpesh “paguajnë” rryshfete me akte seksuale, ndërsa burrat paguajnë me para dhe mallra.⁹² Gratë migrante në qendrat e pritjes ose të tranzitit përballen me rryzique të veçanta të sextorsion-it. Një situatë e ngjashme është raportuar për gratë refugjate.⁹³ Në një rast të tillë, si

• GRUPET E PAKICAVE

Korrupsioni mund të çojë në marginalizimin e pakicave kombëtare, etnike, fetare dhe të tjera në sferën ekonomike dhe politike, pasi korrupsioni do të devijojë më tej burimet nga këto komunitete, do të përkeqësojë pabarazitë dhe do të dëmtojë më tej zhvillimin ekonomik.⁹⁶ Vetëm kohët e fundit më shumë kërkime shkencore kanë prekur çështjen se si janë të lidhura diskriminimi dhe korrupsioni. Është e rëndësishme të theksohet se njerëzit gjithashtu shpesh përballen me diskriminim të shumëfishtë (Ruwanpura, 2008), për shembull një grua e pakicës etnike ka të ngjarë të përballlet me diskriminim si për shkak të gjinisë ashtu edhe për shkak të përkatësisë së saj etnike.

Një studim i fundit nga Transparency International eksploron më tej se si korrupsioni dhe diskriminimi janë të ndërlidhura:

Natyra ndërsektoriale e diskriminimit do të thotë që korrupsioni i penalizon dy herë këto grupe të marginalizuara. Jo vetëm që individët nga këto komunitete luftojnë me format e korrupsionit që rezultojnë në shpërndarjen e veçantë të burimeve, por diskriminimi ndaj këtyre grupeve mund të krijojë mundësi shtesë për zyrtarët e korruptuar që t'i shfrytëzojnë ato. (Bullock dhe Jenkins, 2020, f. 4).

gratë migrante ashtu edhe ato refugjate janë shumë të ndjeshme ndaj shfrytëzimit ku ato detyrohen të kryejnë shërbime seksuale për të mbuluar nevojat e tyre më elementare.⁹⁴ Deri më tani nuk ka asnjë studim mbi rryziquet e veçanta të korrupsionit me të cilat përballen të miturit e pashoqëruar, megjithatë, bazuar në atë që dihet për dhunën (seksuale dhe me bazë gjinore) dhe shfrytëzimin e këtij grupi gjatë migracionit, duhet supozuar se ata janë veçanërisht të pambrojtur ndaj formave jotradicionale të korrupsionit, siç është sextorsion-i (shantazhi seksual).⁹⁵ Vini re se forma specifike e korrupsionit, sextorsion-i, është hulumtuar më në detaje në pjesën 6 të këtij punimi.

Kjo është gjithashtu e lidhur ngushtë me mungesën e përfaqësimit politik. Ajo që është diskutuar në shumë detaje për gratë (shih pjesën më lart), është gjithashtu e vërtetë për komunitetet e tjera të marginalizuara, siç janë grupet indigjene, pakicat etnike ose njerëzit me aftësi të kufizuara: pa përfaqësim politik dhe dukshmëri ekonomike dhe sociale, këto grupe janë edhe më edhe më të pambrojtur ndaj korrupsionit.

Pakicat etnike janë veçanërisht të prekura nga korrupsioni, ku “Fakti që shumë shoqëri të diferencuara etnikisht janë gjithashtu të shtresuara etnikisht (disa grupe etnike kanë status më të lartë ekonomik dhe politik se të tjerët) paraqet një dinamikë tjetër që lidhet me zhvatjet e korrupsionit”.⁹⁷ Edhe në sistemet ku mbizotëron favoritizmi me bazë etnike ose klientelizmi, pakicat do të përjashtohen, gjë që jo vetëm do të kufizojë mirëqenien e tyre sociale dhe ekonomike, por gjithashtu do të gërryjejë besimin tek qeveria.⁹⁸ Një studim mbi Ballkanin Perëndimor tregon se në zonat ku pakicat etnike janë të neglizhuara nga qeveria, ato kanë më shumë gjasa të përdorin praktika joformale për të aksesuar shërbimet bazë.⁹⁹ Duke përdorur një numër të madh vendesh si model, një studim tjetër tregon se pabarazia e lartë etnike lidhet pozitivisht me nivelet më të larta të korrupsionit.¹⁰⁰

⁹² Merkle et al. (2017)

⁹³ United Nations Refugee Agency, United Nations Population Fund, & Women's Refugee Commission (2016)

⁹⁴ Zimmermann, McAlpine, & Kiss (2016)

⁹⁵ Freccero et al. (2017)

⁹⁶ Bullock & Jenkins, 2020, p.3

⁹⁷ Edwards (2021, p.2)

⁹⁸ Bullock & Jenckins (2021)

⁹⁹ Skendaj (2016)

¹⁰⁰ Alesina et al. (2016)

Siç mund të shihet në Shtetet e Bashkuara, “roli i zbatimit të ligjit në riprodhimin e formave të diskriminimit të lidhura ngushtë me korrupsionin” është vënë në plan të parë nga ngjarjet e fundit si protestat Black Lives Matter (Jetët e Zezakëve Kanë Rëndësi).¹⁰¹ Kjo pasqyrohet në mënyrën se si agjencitë e zbatimit të ligjit perceptohen nga pjesë të ndryshme të popullsisë. Në vitin 2017, një sondazh në Shtetet e Bashkuara tregoi se një në tre afrikano-amerikanë e shihte policinë si shumë të korruptuar ndërsa vetëm një e pesta e popullsisë së përgjithshme ndante këtë mendim.¹⁰² Se pakicat etnike janë më të prekura nga korrupsioni në sistemin e drejtësisë penale konfirmohet edhe nga një studim në Ballkanin Perëndimor¹⁰³ që tregon se pakicat etnike kanë një gjasë më të lartë për t’u kërkuar ryshfet nga një zyrtar shtetëror. Në mënyrë të ngjashme, një studim në Shtetet e Bashkuara¹⁰⁴ përcaktoi se “politikanët afrikano-amerikanë janë shënjestruar në mënyrë disproporcionale nga organet e zbatimit të ligjit me akuza për sjellje të pahijshme dhe korrupsion”.¹⁰⁵

Një shembull i një pakice etnike janë Romët dhe Sintët. Një histori diskriminimi dhe persekutimi i ka shtyrë Romët dhe Sintët në marginat e shoqërisë, duke i bërë ata një nga pakicat më të cënueshme

• TOKA DHE BURIMET NATYRORE

Toka është një burim prodhues vendimtar dhe një faktor kyç në rritjen ekonomike, zhvillimin rural dhe sigurinë ushqimore. Siç thekson Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë, “jetesa e shumë njerëzve, veçanërisht të varfërve ruralë, përfshirë edhe gratë, bazohet në aksesin e sigurt dhe të barabartë dhe kontrollin mbi tokën dhe burimet e tjera natyrore”.¹⁰⁹ Globalisht gratë zotërojnë më pak tokë dhe kanë

dhe më të pafavorizuara në Evropë.¹⁰⁶ Romët dhe Sintët përballen me pengesa për aksesin ndaj kujdesit shëndetësor dhe arsimit, shërbimet që ata marrin janë shpesh të cilësisë më të ulët dhe procedurat e regjistrimit mund të jenë sfiduese për t’u kryer plotësisht. Secili prej këtyre problemeve përkeqësohet kur është i pranishëm edhe korrupsioni. Siç vuri në dukje një studim,¹⁰⁷ Romët janë veçanërisht të cënueshëm ndaj zhvatjes kur përpiqen të kenë akses në shërbimet qeveritare. Në rrethana të veçanta, siç është konflikti në Ukrainë, komunitete të tëra Rome mund të zhvendosen, dhe kjo i bën ata edhe më të prekshëm ndaj diskriminimit dhe zhvatjes dhe për rrjedhojë, ndaj pasigurisë së komunitetit në shkallë të gjerë.

Një studim i fundit gjithashtu thekson se sa ngushtë janë të lidhur diskriminimi fetar dhe korrupsioni. Ndërsa kërkimi shkencor mbi këtë duhet ende të zgjerohet, autorët argumentojnë se në qeveritë që “ndërhyjnë rregullisht në praktikën e komuniteteve fetare dhe atyre të besimit, dëshira për kontroll nga ana e shteteve çon në imponimin e politikave dhe praktikave kufizuese që lejojnë diskrecion të konsiderueshëm midis bartësve të detyrës, gjë që nga ana tjetër ofron terrenin e përsosur për mbarështimin e korrupsionit”.

më pak të drejta të sigurta mbi tokën sesa burrat. Gratë përbëjnë mesatarisht më pak se 20 për qind të pronarëve të tokës në botë, por përbëjnë rreth 43 për qind të fuqisë punëtore bujqësore.¹¹⁰

¹⁰¹ Bullock and Jenckins (2021, p.5)

¹⁰² Transparency International (2017)

¹⁰³ Skendaj (2016)

¹⁰⁴ Musgrove (2012)

¹⁰⁵ Bullock and Jenckins (2021, p.8)

¹⁰⁶ Shënimi i redaktorit: www.osce.org/roma-and-sinti

¹⁰⁷ Merkle, Reinold & Siegel (2017b)

¹⁰⁸ Transparency International & Equal Rights Trust (Fondacija za ravnopravnost, ERT) (2021, str. 52).

¹⁰⁹ FAO, Why Gender Equality Matters when dealing with governance of land, <http://www.fao.org/3/a-ax507e.pdf>

¹¹⁰ Editor's note: UN Women, Facts & Figures, www.unwomen.org/en/news/in-focus/commission-on-the-status-of-women-2012/facts-and-figures

Tabela X më poshtë tregon se si shpërndahet pronësia e tokës ndërmjet grave dhe burrave në rajonin e OSBE-së

Tabela X: Shpërndarja e pronarëve bujqësorë sipas gjinisë (femra) në rajonin e OSBE-së¹¹¹

Vendi	Viti	Shuma	% femra	Vendi	Viti	Shuma	% femra
Armenia	2007	NA	29.70%	Letonia	2010	83,390	46.80%
Austria	2010	150,170	34.50%	Lituania	2010	199,910	47.70%
Belgjika	2010	42,850	15.10%	Luksemburgu	2010	2,200	15.90%
Bullgaria	2010	370,490	22.80%	Malta	2010	12,530	11.10%
Kanadaja	2011	293,925	27.40%	Mali i Zi	2010	48,870	12.90%
Kroacia	2010	233,280	22.00%	Holanda	2010	72,320	6.10%
Qipro	2010	38,860	20.60%	Norvegjia	2010	46,620	14.10%
Republika Çeke	2010	22,860	15.10%	Polonia	2010	1,506,620	29.70%
Danimarka	2010	42,100	9.00%	Portugalia	2010	305,270	29.30%
Estonia	2010	19,610	35.80%	Rep. e Moldavise	2011	902,214	36.30%
Finlanda	2010	63,870	11.10%	Rumania	2010	3,859,040	32.40%
Franca	2010	516,100	22.70%	Serbia	2002	778,891	18.10%
Gjeorgjia	2004	728,950	29.10%	Slovakia	2010	24,460	17.00%
Gjermania	2010	299,130	8.40%	Slovenia	2010	74,650	27.20%
Greqia	2010	723,060	27.70%	Spanja	2010	989,800	21.70%
Hungaria	2010	576,810	26.30%	Suedia	2010	71,090	15.40%
Islanda	2010	2,590	15.40%	Zvicra	2010	59,070	6.50%
Irlanda	2010	139,890	11.50%	Mbretëria e Bashkuar	2010	186,800	13.10%
Italia	2010	1,620,880	30.70%	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	2012	2,109,303	13.70%
Kirgistani	2002	244,404	12.40%				

Burimi: FAO (2021). Baza e të dhënave gjinore dhe të drejtave të tokës –

Statistikat e gjinisë dhe tokës. www.fao.org/gender-landrights-database/data-map/statistics/en/?sta_id=982

Jo të gjithë anëtarët e OSBE-së janë përfshirë në bazën e të dhënave

Siç është rasti me sektorët e tjerë, korrupsioni mund të ndikojë negativisht në njohjen e të drejtave të tokës. Ryshfeti e bën transferimin e tokës shumë të kushtueshme dhe pengon mundësitë e mbrojtjes së tokës.¹¹² Korrupsioni mund të lidhet me regjistrimin e tokës, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, menaxhimin e burimeve dhe investimet.¹¹³ Korrupsioni mund të përkeqësojë pabarazitë gjinore para-ekzistuese në qasjen ndaj tokës dhe kjo kërcënon më tej mirëqenien ekonomike dhe sociale të grave dhe në fund të fundit ndikon në jetesën e familjeve të tyre. Pjesa më e madhe e pasigurisë rreth pronësisë së tokës për gratë është e lidhur drejtpërdrejt me rolet gjinore dhe aksesin e grave në mundësinë e vendimmarrjes.¹¹⁴

¹¹¹ „Pronari bujqësor është personi civil ose juridik, i cili merr vendimet kryesore në lidhje me përdorimin e burimeve dhe ushtron kontroll menaxherial mbi tokën bujqësore. Pronari bujqësor ka përgjegjësi teknike dhe ekonomike për tokën.” (FAO, 2021)

¹¹² Transparency International, 2011.

¹¹³ Amanda Richardson, Stephanie Debere, Annette Jaitner & Rukshana Nanayakkara: Gendered Land Corruption and the Sustainable Development Goals (Transparency International 2018)

¹¹⁴ Transparency International (2018)

A PËRJETOJNË BURRAT DHE GRATË FORMA TË NDRYSHME TË KORRUPSIONIT?

ROLI I SHANTAZHIT SEKSUAL (SEKSTORSION-IT)

Koncepti ynë tipik i “korrupsionit” është një shkëmbim parash, mallrash ose pushteti. Megjithatë, hulumtimi ka hedhur dritë mbi një “monedhë” tjetër të korrupsionit – shërbimet seksuale. Termi që përdoret për të përshkruar këtë lloj specifik të korrupsionit - sekstorsion¹¹⁵ (zhvatje seksuale), u krijua nga Shoqata Ndërkombëtare e Grave Gjyqtare (IAWJ). Sekstorsion-i përkufizohet si “shpërdorim i pushtetit për të marrë një favor seksual.”¹¹⁶ Kjo formë korrupsioni është e përhapur dhe ndërsa prek në mënyrë disproporcionale gratë, edhe burrat dhe djemtë gjithashtu mund t’i nënshtrohen sekstorsion-it.¹¹⁷

Që një akt të konsiderohet si sekstorsion (zhvatje seksuale) duhet të jenë të pranishëm dy elementë: një korrupsion dhe një komponent seksual.

Për të parin, “keqbërësi duhet të ketë një pozicion autoriteti dhe duhet të abuzojë me atë autoritet duke u përpjekur të kërkojë, ose duke pranuar, një favor seksual në këmbim të ushtrimit të pushtetit që i është besuar atij” [komponenti i korrupsionit].¹¹⁸ Së dyti, akti “duhet të përfshijë një kërkesë - qoftë të qartë apo të nënkuptuar - për t’u përfshirë në aktivitet seksual” [komponenti seksual].¹¹⁹ Për të dalluar sekstorsion-in nga format e tjera të abuzimit seksual, tre komponentë janë të pranishëm në një incident sekstorsion-i: a) duhet të ketë abuzim me autoritetin; b) duhet të përfshijë një shkëmbim *kuid pro quo* (favor a avantazh i dhënë në këmbim të diçkaje), dhe c) sekstorsion-i mbështetet në detyrimin psikologjik dhe jo në forcën fizike.¹²⁰

Duhet theksuar se ky konceptualizim i sekstorsion-it nuk është një përkufizim ligjor, por një përshkrim i një fenomeni. Megjithatë, sekstorsion-i trajtohet përmes ligjeve për

ngacmimin seksual, veçanërisht përmes atyre të ngacmimit seksual *quid pro quo*.

Sekstorsion-i ndodh në vendin e punës, por nuk kufizohet vetëm në këtë sektor. Ai mund të ndodhë në sektorin e drejtësisë, në mjediset arsimore ose në qendrat e pritjes së migracionit ose kampet e refugjatëve, ndër të tjera.

Pak kërkime shkencore janë kryer në mënyrë specifike për këtë lloj shkëmbimi korruptiv¹²¹, megjithatë studimet ekzistuese sugjerojnë se problemi është i përhapur dhe se gjithashtu disa faktorë i lënë disa individë veçanërisht të prekshëm ndaj sekstorsion-it.

Përveç gjinisë, këta faktorë përfshijnë moshën, të qenit me një aftësi të kufizuar, të qenit me një status të padokumentuar dhe norma të tjera shoqërore.¹²² Megjithatë, nevojitet ende një diskutim shumë më i nuancuar rreth asaj se si popullatat e cenueshme dhe të marginalizuara janë të prekura nga sekstorsion-i. Po kështu, hulumtimi cilësor dhe sasior do të ndihmonte për të sqaruar përhapjen dhe pasojat afatgjata të kësaj forme korrupsioni tek ata që preken prej tij.

Për shkak se sekstorsion-i nuk njihet gjerësisht, në ligj ose në mjediset e tjera, ka të dhëna të kufizuara për këtë formë korrupsioni dhe akte të tilla korruptive rrallë do të akuzoheshin si të tilla, nëse fare. Deri kohët e fundit, jo vetëm që shkëmbimet korruptive që përfshinin aktet seksuale si një formë pagese korruptive janë injoruar gjerësisht, por rrallëherë ato janë kuptuar si korrupsion, dhe për këtë arsye zyrtarët rrallë akuzoheshin.¹²³ Kjo situatë krijon pandëshkueshmëri dhe i mohon drejtësinë viktimave.

¹¹⁵ Një shumëllojshmëri e gjerë termash përdoren në sistemet kulturore dhe ligjore për të përshkruar këtë fenomen në këtë moment, të tilla si “favorizime seksuale”, “ngacmim seksual”, “ngacmim *quid pro quo*” ose “seks transaksional”. Problemi me përdorimin e kësaj terminologjie është se ata shpesh mohojnë aspektin e ekstorsion-it (zhvatjes) dhe mekanizmat themelorë të pushtetit. Për më tepër, këto terma nuk e bëjnë mjaft të qartë aspektin e korrupsionit (Merkle, 2018)

¹¹⁶ IAWJ (Međunarodno udruženje žena sudaca) (2012, str. 9)

¹¹⁷ Feigenblatt (2020)

¹¹⁸ IAWJ (Međunarodno udruženje žena sudaca) (2012, str. 9)

¹¹⁹ IAWJ (Međunarodno udruženje žena sudaca) (2012, str. 9)

¹²⁰ IAWJ (Međunarodno udruženje žena sudaca) (2012)

¹²¹ Wängnerud (2012)

¹²² Merkle et al. (2017 Feigenblatt (2020)

¹²³ Feigenblatt (2020)

Aty ku janë kryer studime për sekstorsion-in, të dhënat janë tronditëse. Barometri i Korrupsionit Global për Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut zbuloi se një në pesë njerëz ka përjetuar korrupsion ose njëh dikë që e ka përjetuar atë.¹²⁴ Në Amerikën Latine dhe Karaibe, një në pesë persona ka përjetuar sekstorsion ose njëh dikë që e ka përjetuar, dhe 71 për qind e të anketuarve mendojnë se sekstorsion-i ndodh të paktën herë pas here.¹²⁵ Mungesa e të dhënave për gjininë dhe korrupsionin në rajonin e OSBE-së sugjeron nevojën për anketa të synuara që do të informonin për nismat dhe politikat kundër korrupsionit.

Hulumtimet mbi sekstorsion-in që ndodh në vendin e punës tregon se ka ndikime të thella në shëndetin psikologjik dhe fizik.¹²⁶ Sekstorsion-i në vendin e punës shoqërohet me rezultate të tilla negative si ulja e kënaqësisë në punë, përkushtimi më i ulët organizativ, tërheqja nga puna, shëndeti i keq fizik dhe mendor, edhe madje me simptoma të çrregullimit të stresit post-traumatik.¹²⁷

Edhe nga kërkimet e kufizuara akademike të disponueshme mbi sekstorsion-in ose korrupsionin seksual, ekziston një nevojë e qartë për të zgjeruar pikëpamjen standarde të korrupsionit me në qendër mashkullin që fokusohet në shkëmbimin e parave dhe mallrave dhe në përfshirjen e akteve seksuale si monedhë shkëmbimi.¹²⁸ Po kështu, diskutimet mbi korrupsionin duhet të përfshijnë sekstorsion-in si “përqendrimi në natyrën gjinore jo vetëm të pasojave apo shkaqeve të korrupsionit, por vetë akti duhet të ndihmojë në riformësimin dhe zgjerimin e përkufizimit të korrupsionit dhe në përgjithësi të çojë në një konceptualizim më gjithëpërfshirës, i cili do të ndihmojë gjithashtu në përshkrimin e përvojave thelbësisht të ndryshme të korrupsionit nga ana e grave.”¹²⁹

¹²⁴ Kukutschka & Vrushi, 2019.

¹²⁵ Pring & Vrushi, 2019.

¹²⁶ Fitzgerald (1993), O'Connell & Korabik (2000), Willness et al. (2007)

¹²⁷ Willness et al. (2007)

¹²⁸ Merkle et al. (2017)

¹²⁹ Merkle (2018, str. 57)

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Hulumtimi akademik mbi korrupsionin dhe gjininë ka dhënë kontribute të rëndësishme në kuptimin që ne kemi për këtë fenomen, jo vetëm në lidhje me natyrën e korrupsionit dhe përpjekjeve kundër korrupsionit, por edhe me realitetet praktike të burrave dhe grave të prekura nga korrupsioni. Megjithatë, për shkak se pjesa më e madhe e hulumtimit është fokusuar në marrëdhënien ndërmjet pjesëmarrjes politike të grave dhe korrupsionit, mbeten pyetje të

rëndësishme në lidhje me ndikimet e korrupsionit tek gratë dhe burrat në sektorë dhe mjedise të tjera. Pavarësisht mungesës së studimeve akademike, përpjekjet kundër korrupsionit janë duke u zhvilluar në shumë sektorë. Këto masa, megjithëse nuk janë zhvilluar domosdoshmërisht me një lente gjinore, janë gjithsesi premtuese për sa i përket përshtatjes ndaj nismave dhe politikave më të gjera kundër korrupsionit dhe atyre me ndjeshmëri gjinore.

PRAKTIKAT E MIRA NË ZHVILLIM

Ky dokument përfshin rezultatet e një rishikimi paraprak të praktikave të mira në luftën kundër korrupsionit midis Shteteve pjesëmarrëse. Shembujt, të dhënë më poshtë, sugjerojnë se një studim më i thelluar do të ishte i vlefshëm për të identifikuar qasjet efektive për përsëritje të mundshme.

ARSIMI



Integriteti i Sistemeve Arsimore (INTES) është një metodologji e vlerësimit të rrezikut të korrupsionit që është krijuar posaçërisht për sektorin e arsimit dhe është përdorur nga Fondacioni i Shoqërisë së Hapur në Armeni dhe nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) në Ukrainë. INTES mund të përshtatet për të nxjerrë në pah edhe aspektet specifike gjinore të korrupsionit në sektorin e arsimit dhe për të krijuar mjete për ta trajtuar atë.

PROKURIMI PUBLIK




Sipërmarrëset femra përbëjnë vetëm rreth një për qind të tregut në mbarë botën, dhe bizneset e grave shpesh përballen me pengesa për të hyrë në tenderët e prokurimit dhe për të fituar kontrata. Bërja e proceseve të prokurimit më gjithëpërfshirëse për gratë jo vetëm që gjeneron rezultate pozitive për gratë sipërmarrëse, por gjithashtu shpesh çon në kontrata më të mira dhe kursime më të mëdha për qeverinë.¹³⁰ Përveç kësaj, prokurimi i zgjuar gjinor mund të ndihmojë në uljen e korrupsionit duke e bërë procesin më të përgjegjshëm, transparent dhe pjesëmarrës. Instituti Shqiptar i Shkencës kreu një studim mbi proceset e prokurimit në vend. Analiza e të dhënave që ata mblodhën ofroi një mundësi për të studiuar efektivitetin e politikave që synojnë mbështetjen e grave sipërmarrëse në sistemin e prokurimit dhe ofroi dëshmi për të rritur mbështetjen për gratë në tregun e prokurimit.¹³¹

¹³⁰ Kirya (2019)

¹³¹ medium.com/@opencontracting/using-open-data-to-boost-business-opportunities-for-women-in-albania-473296de4f27

SHËRBIMI CIVIL:



Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP në anglisht; PNUD në shqip) ka zhvilluar një metodologji për zyrat e tij të vendeve në Evropë dhe Azinë Qendrore për të “ulur pabarazitë gjinore, për të promovuar qeverisjen e mirë dhe për të parandaluar korrupsionin përmes këshillave për politikën dhe asistencës teknike”.¹³² PNUD-i e bazon punën e tij në një anketë të punonjësve meshkuj dhe femra të shërbimit civil që përdoret për të mbledhur informacione rreth efekteve gjinore të korrupsionit. Rezultatet e anketës mund të përdoren më pas për të reformuar administratën publike në një mënyrë të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore dhe për të ofruar shërbime pa korrupsion.

KRIMINALIZIMI I SEKSTORSION-IT:



Në shumë juridiksione legjislacioni kundër korrupsionit fokusohet në përfitimet financiare të marra nëpërmjet korrupsionit dhe përjashton llojet e tjera të përfitimeve si aktet seksuale. Edhe në juridiksione që kanë një gjuhë më të gjerë, si “përparësi tjetër” (Mbretëria e Bashkuar) ose “përfitim i çdo lloji” (Nigjeri), të cilat teorikisht mund të përfshijnë sekstorsionin, në praktikë, gjykatat rrallë e referojnë këtë formë korrupsioni në gjykime. Përjashtim bën Rumania, ku ligji kriminalizon në mënyrë eksplicite abuzimin e pushtetit për përfitime seksuale.¹³³ Juridiksione të tjera duhet të ndjekin këtë shembull, duke siguruar që legjislacioni të mos lejojë mundësinë e ndjekjes penale të viktimave.

¹³² UNDP, n.d.

¹³³ Ligji nr 286 i datës 17 korrik 2009 i Kodit Penal f 299

REKOMANDIME PËR SHQYRTIM NGA STRUKTURAT EKZEKUTIVE TË OSBE-SË¹³⁴

Rekomandimet e mëposhtme bazohen në një rishikim fillestar se si literatura akademike trajton lidhjen e gjinisë dhe korrupsionit. Rekomandimet sugjerohen si pika fillestare për diskutim të mëtejshëm.

RRITJA E TË KUPTUARIT TË FORMAVE GJINORE TË KORRUPSIONIT:




Roli i sekstorsion-it, si një formë korrupsioni që prek në mënyrë disproporcionale gratë dhe vajzat, ende nuk është kuptuar mirë dhe në përgjithësi nuk trajtohet nga organizatat ndërkombëtare. OSBE-ja mund të marrë një rol udhëheqës në rritjen e ndërgjegjësimit për ndikimet negative të sekstorsion-it, me një fokus të veçantë në mënyrën se si sekstorsion-i zhvillohet në shtetet e brishta dhe të prekura nga konflikti, në sigurinë kufitare dhe në lidhje me migrimin dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Për shembull, OSBE-ja mund të mbështesë kërkime të mëtejshme në lidhje me sekstorsion-in dhe të përkrahë përfshirjen e kësaj forme korrupsioni në aktivitetet e saj programore.

MBLEDHJA E TË DHËNAVE PËR FORMAT GJINORE TË KORRUPSIONIT:



Transparency International ka filluar të mbledhë të dhëna për sekstorsion-in në Barometrin e tyre të Korrupsionit Global. Megjithatë, për momentin të dhënat janë të disponueshme vetëm për Amerikën Latine dhe Karaibet dhe Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut. Të dhëna të rregullta dhe të krahasueshme të ndara sipas gjinisë nevojiten për të identifikuar se ku ndodh sekstorsion-i (p.sh. në cilët sektorë ose institucione) dhe në cilat situata ka më shumë gjasa të ndodhë. Duke pasur parasysh fushëveprimin e saj rajonal, OSBE-ja është e pozicionuar mirë për të ndihmuar me mbledhjen e të dhënave, si dhe me mbledhjen e informacionit cilësor të thelluar se si dhe ku ndodh sekstorsion-i dhe kush është më i prekur nga ai në Shtetet pjesëmarrëse, veçanërisht në mjediset (post) konfliktuale.

KRIJIMI I PROGRAMEVE DHE MEKANIZMAVE RAPORTUES KUNDËR KORRUPSIONIT DHE ME NDJESHMËRI GJINORE



Në nivel global, shumica e programeve kundër korrupsionit nuk marrin në konsideratë se si burrat dhe gratë preken ndryshe nga korrupsioni. Prandaj, ato rrezikojnë që burrat dhe gratë të mos përfitojnë njësoj nga ndërhyrjet kundër korrupsionit ose që programe të tilla mund të kenë pasoja negative (të paqëllimta) si për burrat ashtu edhe për gratë. Integrimi gjinor¹³⁵ duhet të jetë pjesë integrale e programeve kundër korrupsionit. OSBE-ja ka mandatin dhe kapacitetin për të integruar çështjen gjinore në programet e saj kundër korrupsionit dhe duke dokumentuar këtë proces, ajo gjithashtu mund të ofrojë udhëzime të rëndësishme se si të zbatohet një perspektivë gjinore në hartimin dhe zbatimin e projektit.

Për më tepër, gratë duhet të fuqizohen për të raportuar korrupsionin, dhe veçanërisht sekstorsion-in. Kjo kërkon mekanizma raportimi të ndjeshëm ndaj gjinisë, që të jenë të sigurta dhe të aksesueshme dhe që të marrin parasysh aspektet kulturore (p.sh. mekanizmat duhet t'u mundësojnë grave të raportojnë korrupsionin tek gratë e tjera, veçanërisht kur raportojnë rastet e sekstorsion-it). Mekanizmat gjithashtu duhet të jenë transparente, të përgjegjshme dhe të pavarura. OSBE-ja mund të ndihmojë Shtetet pjesëmarrëse për të zhvilluar dhe zbatuar mekanizma raportimi të ndjeshëm ndaj gjinisë.

¹³⁴ Rekomandimet u hartuan falë kontributit dhe feedback-ut të mbledhur gjatë takimit të parë të grupit të brendshëm të punës të OSBE-së për çështjet gjinore dhe anti-korrupsion (qershor 2021)

¹³⁵ Integrimi gjinor është procesi i përfshirjes së perspektivës gjinore në të gjitha aspektet e zhvillimit dhe zbatimit të programit.

PËRFSHIRJA E PERSPEKTIVËS GJINORE NË PËRDPJËKJET KUNDËR KORRUPSIONIT NË PUNËN ME PAKICAT ETNIKE DHE FETARE:



Programet e OSBE-së për promovimin e të drejtave të Romëve dhe Sintëve mund të rrisin ndërgjegjësimin për rreziqet më të larta të korrupsionit dhe natyrën gjinore të këtij rreziku në mesin e këtyre komuniteteve. Çështja e korrupsionit është veçanërisht e rëndësishme për programet që punojnë për zhvendosjen e brendshme, arsimin dhe strehimin. Përveç kësaj, programet për qeverisjen e mirë mund të rrisin fokusin e tyre në mbrojtjen e komuniteteve më të marginalizuara nga korrupsioni dhe adresimin e përvojave të grave brenda këtyre komuniteteve.

MBËSHTETJA E GRAVE SI NJË FORCË KUNDËR KORRUPSIONIT



Gratë sjellin në tryezë çështje të ndryshme, jo vetëm si aktore politike, por edhe si aktiviste dhe qytetare të angazhuara. Kjo është treguar të jetë e vërtetë për fushat e politikave ku gratë janë të nënpërfaqësuar dhe të marginalizuara ose të prekura në mënyrë disproporcionale. OSBE-ja mund të mbështesë rrjetet e grave, koalicionet dhe organizatat e shoqërisë civile dhe të ndihmojë në rritjen e kapaciteteve të tyre në punën kundër korrupsionit.

RRITJA E TRANSPARENCËS:



Në punën e OSBE-së rreth iniciativave të dixhitalizimit si një mjet për të rritur transparencën, vëmendje duhet t'i kushtohet ndarjes dixhitale gjinore që i pengon gratë të kenë akses në burimet dixhitale në të njëjtën masë si burrat.¹³⁶ Qasja në njohuritë dhe mjetet dixhitale duhet të zgjerohet dhe masa specifike duhet të përdoren për të kapërcyer çdo boshllëk dixhital midis grave dhe burrave.

¹³⁶ Shënimi i redaktorit

REFERENCAT

- ADB. 2018. Mësime të Reja mbi Sipërmarrjen e Grave në Azi dhe Paqësor: Studime të Rasteve nga Banka Aziatike për Zhvillim dhe Fondacioni i Azisë (Emerging Lessons on Women's Entrepreneurship in Asia and the Pacific: Case Studies from the Asian Development Bank and The Asia Foundation).
- AFDB. (2009). Listë Kontrolli për Integrimin e Gjinisë në Qeverisje (Checklist for Mainstreaming Gender in Governance). <https://www.afdb.org/fileadmin/uploads/afdb/Documents/Policy-Documents/Checklist%20for%20Gender%20Mainstreaming%20in%20Governance%20Programmes%20EN.pdf>
- Alatas, V., Cameron, L., Chaudhuri, A., Erkal, N., & Gangadharan, L. (2009). Gjinia, kultura dhe korrupsioni: Vështrime nga një analizë eksperimentale (Gender, culture, and corruption: Insights from an experimental analysis). *Southern Economic Journal*, 75(3), 663–80.
- Alesina, Alberto, Stelios Michalopoulos, and Elias Papaioannou. 2016. "Pabarazia Etnike." ("Ethnic Inequality.") *Journal of Political Economy* 124(2): 428–88.
- Alexander, A. C., & Bågenholm, A. (2018). A ka rëndësi gjinia? Angazhimi i politikaneve femra në përpjekjet kundër korrupsionit (Does gender matter? Female politicians' engagement in anti-corruption efforts). In H. Stensöta, & L. Wängnerud (eds), *Gjinia dhe Korrupsioni – Rrënjët Historike dhe Rrugët e Reja për Hulumtime (Gender and Corruption—Historical Roots and New Avenues for Research)* (pp. 171–189), Cham, CH: Palgrave Macmillan.
- Alhassan-Alolo, N. (2007). Gjinia dhe Korrupsioni: Testimi i konsensusit të ri (Gender and corruption: Testing the new consensus). *Public Administration and Development*, 27(3), 227–37.
- Andvig, J. C., Fjeldstad, O.-H., Amundsen, I., Sissener, T., & Søreide, T. (2001). *Korrupsioni. Një Rishikim i Kërkimeve Bashkëkohore (Corruption. A Review of Contemporary Research)* (CMI Report 2001:7). Chr. Michelsen Institute (CMI).
- Andvig, J. C., Fjeldstad, O., Amundsen, I., Søreide, T., & Sissener. (2000). *Hulumtim mbi Korrupsionin. Një studim i orientuar drejt politikave (Research on Corruption A policy oriented survey)*. Chr. Michelsen Institute (CMI) & Norwegian Institute of International Affairs (NUPI).
- Anzia, S. F., & Berry, C. R. (2011). Efekti Jackie (dhe Jill) Robinson: Pse kongresistet ua kalojnë kongresistëve? (The Jackie (and Jill) Robinson effect: Why do congresswomen outperform congressmen?) *American Journal of Political Science*, 55(3), 478–93.
- Apergis, N., Dincer, O. C., & Payne, J. E. (2009). Marrëdhënia midis korrupsionit dhe pabarazisë së të ardhurave në Shtetet e Bashkuara: Dëshmi nga një model i bashkëintegritit të panelit dhe korigjimit të gabimeve (The relationship between corruption and income inequality in U.S. states: Evidence from a panel cointegration and error correction model). *Public Choice*, 145(1–2), 125–135.
- Arriola, L. R., & Johnson, M. C. (2014). Politika etnike dhe fuqizimi i grave në Afrikë: Emërimet ministrore në kabinetet ekzekutive (Ethnic politics and women's empowerment in Africa: Ministerial appointments to executive cabinets). *American Journal of Political Science*, 58(2), 495–510.
- Baker, C. N. (1995). Zhvatja Seksuale: Kriminalizimi i Ngacmimit Seksual Quid Pro Quo (Sexual Extortion: Criminalizing Quid Pro Quo Sexual Harassment). *Law & Inequality: A Journal of Theory and Practice*, 13(1), 213–251.
- Barnes, T. D. (2016). *Sjellja Legjislative Gjinore: Kufizimet Institucionale dhe Bashkëpunimi (Gendering Legislative Behavior: Institutional Constraints and Collaboration)*. Cambridge, UK: Cambridge University Press.
- Barnes, T. D., & Beaulieu, E. (2014). Stereotipet gjinore dhe korrupsioni: Si ndikojnë kandidatët në perceptimet e mashtrimit zgjedhor (Gender stereotypes and corruption: How candidates affect perceptions of election fraud). *Politics & Gender*, 10(3), 365–91.
- Barnes, T. D., & Beaulieu, E. (2019). Gratë politike, institucionet dhe perceptimet e korrupsionit (Women politicians, institutions, and perceptions of corruption). *Comparative Political Studies*, 52(1), 134–167.

- Bauhr, M., Charron, N., & Wängnerud, L. (2018). Përjashtim apo interesa? Pse femrat në postet e zgjedhura reduktojnë korrupsionin e vogël dhe të madh (Exclusion or interests? Why females in elected office reduce petty and grand corruption). *European Journal of Political Research*. doi:10.1111/1475-6765.12300
- Bayley, D. H. (1966). Efektet e Korrupsionit në një Komb në Zhvillim (The Effects of Corruption in a Developing Nation). *The Western Political Quarterly*, 19(4), 719–732.
- Beck, L. J. (2003). Demokratizimi dhe publiku i fshehur: Ndikimi i rrjeteve të patronazhit tek gratë senegaleze (Democratization and the hidden public: The impact of patronage networks on Senegalese women). *Comparative Politics*, 35(2), 147–69.
- Benstead, L. J., & Lust, E. (2018). Pse disa votues preferojnë kandidatet femra? Roli i moskorrumpueshmërisë së perceptuar në zgjedhjet arabe (Why do some voters prefer female candidates? The role of perceived incorruptibility in Arab elections). In H. Stensöta, & L. Wängnerud (eds), *Gjinia dhe Korrupsioni – Rrënjët Historike dhe Rrugët e Reja për Hulumtime (Gender and Corruption: Historical Roots and New Avenues for Research)* (pp. 83–104), Cham, CH: Palgrave Macmillan.
- Bhalotra, S., & Clots-Figueras, I. (2014). Shëndeti dhe agjencia politike e grave (Health and the political agency of women). *American Economic Journal: Economic Policy*, 6(2), 164–97.
- Bjarnegård, E. (2013). Gjinia, Institucionet Informale dhe Rekrutimi Politik: Shpjegimi i Dominimit Mashkullor në Përfaqësimin Parlamentar (Gender, Informal Institutions and Political Recruitment: Explaining Male Dominance in Parliamentary Representation). London: Palgrave Macmillan.
- Bjarnegård, E. (2018). Duke u përqëndruar tek mashkulloriteti dhe rrjetet e dominuara nga meshkujt në korrupsion (Focusing on masculinity and male-dominated networks in corruption). In H. Stensöta, & L. Wängnerud (eds), *Gjinia dhe Korrupsioni – Rrënjët Historike dhe Rrugët e Reja për Hulumtime (Gender and Corruption—Historical Roots and New Avenues for Research)* (pp. 257–273), Cham, CH: Palgrave Macmillan.
- Bjarnegård, E., & Kenny, M. (2016). Krahasimi i përzgjedhjes së kandidatëve: Një qasje institucionaliste feministe (Comparing candidate selection: A feminist institutionalist approach). *Government and Opposition*, 51(3), 370–92.
- Blackden, C. M., & Wodon, Q. (2006). Gjinia, Përdorimi i Kohës dhe Varfëria në Afrikën Nën-Sahariane (Gender, Time Use, and Poverty in Sub-Saharan Africa). World Bank Publications.
- Boehm, F., & Sierra, E. (2015). Ndikimi gjinor i korrupsionit: Kush vuan më shumë: Burrat apo gratë? (The gendered impact of corruption: Who suffers more—Men or women?) (U4 Brief 2015 No 9). Retrieved from the Chr. Michelsen Institute website: <http://www.u4.no/publications/the-gendered-impact-of-corruption-who-suffers-more-men-or-women/downloadasset/3882>
- Branisa, B., & Ziegler, M. (2011). Rishqyrtimi i lidhjes midis gjinisë dhe korrupsionit: Roli i institucioneve sociale (Reexamining the link between gender and corruption: The role of social institutions). Retrieved from the EconStor website: <http://www.econstor.eu/handle/10419/48324>
- Brollo, F., & Troiano, U. (2016). Çfarë ndodh kur një grua fiton zgjedhjet? Dëshmi nga gara të ngushta në Brazil (What happens when a woman wins an election? Evidence from close races in Brazil). *Journal of Development Economics*, 122, 28–45.
- Bruni, V., & Merkle, O. (2018). Efektet Gjinore të Korrupsionit në Rrugën e Mesdheut Qendror (Gendered Effects of Corruption on the Central Mediterranean Route). *ECDPM Great Insights*, 7(1 (Winter 2018)). <http://ecdpm.org/great-insights/migration-moving-backward-moving-forward/gendered-corruption-central-mediterranean/>
- Bullock, J & Jenkins, M. (2020). Korrupsioni dhe Margjinalizimi (Përgjigja e Zyrës së Ndhmës Kundër Korrupsionit të Transparency International) (Corruption and Marginalization (Transparency International Anti-Corruption Helpdesk Answer)). Retrieved from the Transparency Knowledgehub Website: <https://knowledgehub.transparency.org/helpdesk/corruption-and-marginalisation>

- Buvinic, M., Das Gupta, M., Casabonne, U., & Verwimp, P. (2013). Konflikti i dhunshëm dhe pabarazia gjinore: Një vështrim i përgjithshëm (Dokumenti i punës për hulumtimin e politikave 6371). (Violent conflict and gender inequality: An overview (Policy research working paper 6371)). Washington, DC: World Bank.
- Byrnes, J. P., Miller, D. C., & Schafer, W. D. (1999). Dallimet gjinore në marrjen e rrezikut: Një meta-analizë (Gender differences in risk taking: A meta-analysis). *Psychological Bulletin*, 125(3), 367–83.
- Campos, N. F., Dimova, R., & Saleh, A. (2016). Korrupsioni dhe rritja ekonomike: Një anketë ekonometrike e provave (Corruption and economic growth: An econometric survey of the evidence). *Journal of Institutional and Theoretical Economics JITE*, 172(3), 521–543
- Capraro, C., & Rhodes, F. (2016, April 7). Pse Letrat e Panamasë janë një çështje feministe (Why the Panama Papers are a feminist issue). Retrieved June 23, 2018, from Open Democracy website: <https://www.opendemocracy.net/5050/chiara-capraro-francesca-rhodes/why-panama-papers-are-feminist-issue>
- Charron, N., Dijkstra, L. and Lapuente, V. (2014). Hartëzimi i Ndarjes Rajonale në Evropë: Një Masë për Vlerësimin e Cilësisë së Qeverisë në 206 Rajone Evropiane (Mapping the Regional Divide in Europe: A Measure for Assessing Quality of Government in 206 European Regions). *Social Indicators Research*, 122(2), pp. 315–346.
- Chaudhuri, A. (2012). Kapitulli 2 Gjinia dhe korrupsioni: Një Studim i Provave Eksperimentale (Chapter 2 Gender and Corruption: A Survey of the Experimental Evidence). In D. Serra, & L. Wantchekon (eds), *Hulumtimi në Ekonominë Eksperimentale: Përparime të Reja në Kërkimet Eksperimentale mbi Korrupsionin* (Research in Experimental Economics: New Advances in Experimental Research on Corruption (Vol. 15, pp. 13–49), Bingley: Emerald Group.
- Chen, M. A. (2001). Gratë dhe Informaliteti: Një Pamje Globale, Lëvizja Globale (Women and Informality: A Global Picture, the Global Movement). *SAIS Review*, 21(1), 71–82.
- Chêne, M. (2009). Gjinia dhe Korrupsioni në ndihmën humanitare (Gender and Corruption in humanitarian assistance). (U4 Expert Answer 223) Retrieved from the Chr. Michelsen Institute website: <https://www.u4.no/publications/gender-and-corruption-in-humanitarian-assistance.pdf>
- Chêne, M., Clench, B., & Fagan, C. (2010). Korrupsioni dhe gjinia në ofrimin e shërbimeve: Ndikimet e pabarabarta (Corruption and gender in service delivery: The unequal impacts) (Working Paper 02/2010). Berlin: Transparency International.
